



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr.15 datë 25.06.2014

**PËR
“EMËRTIMIN “MAHMUD BOBRATI”, TË RRUGËS NGA PRERJA ME RRUGËN
E “DURRËSIT” NË KRAH TË GJIMNAZIT “QEMAL STAFA”, QË VAZHDON NË
BRENDËSI TË BLOKUT TË BANIMIT, DERI NË PRERJEN ME RRUGËN
“MINE PEZA”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Mahmud Bobrati”, të rrugës nga prerja me rrugën e “Durrësit” në krah të gjimnazit “Qemal Stafa”, që vazhdon në brendësi të bllokut të banimit, deri në prerjen me rrugën “Mine Peza”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), si dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin “Mahmud Bobrati”, të rrugës nga prerja me rrugën e “Durrësit” në krah të gjimnazit “Qemal Stafa”, që vazhdon në brendësi të bllokut të banimit, deri në prerjen me rrugën “Mine Peza”, (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI